

Programi: Banka dhe Financa

Studimet Master

Punim Masteri

**NDIKIMI I NVM-VE NË RRITJEN E PUNËSIMIT NË
KOMUNËN E OBILIQIT**

Kandidati:

Arbnorë Zeqiri Çerkezi

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Fëllanzë Pula

Prishtinë, 2019

Abstract

In this research paper we will talk about small and medium-sized enterprises (SMEs) that play a very important role in a country's economy, considering their importance in generating economic growth and employment. Further development of the SME sector with special focus on employment is important. This is because SMEs represent the overwhelming majority of private businesses operating in the country and easily adapt to market conditions, and are therefore the main source of employment generation. Currently, almost all enterprises in the Municipality of Obiliq belong to the category of small and medium enterprises. SMEs in the country account for 99.9% of registered businesses, most of them - about 96% are micro-enterprises with up to 9 workers - hence having the largest share of employment (82.9%) and value added to the country's economy (69.8%). For this reason, SMEs are important in terms of providing employment in the Obiliq municipality with four out of five employees in the non-financial business economy belong to the group employed in one SME and two out of five employees are employed in a micro-business.

Since SMEs represent 98% of businesses and 67% of jobs, they represent the main driver for economic development, innovation, employment and social integration in the EU. Therefore, the European Commission promotes successful entrepreneurship and improves the business environment for SMEs.

Key words (key): SMEs, Small Businesses, Economic Development, Innovations. Municipality of Obiliq, etc.

1.1. Metodat dhe teknikat e hulumtimit

Materiali që është përdorë në këtë punim i referohet më shumë nga të dhënat primare nga dokumentet zyrtare, po ashtu këtë punim e kam pasuruar me të dhënat e fituara gjatë studimeve dhe web faqet zyrtare.

Po ashtu material tjetër i rëndësishëm, i cili përdoret për të fituar informacione të rëndësishme, është literatura nga autorë të ndryshëm relevantë nga fusha e së biznesit.

Metodat kryesore që do përdoren në këtë studim do jenë: Metoda e analizës, metoda krahasuese, metoda e studimit të rasteve, sinteza, induksioni, deduksioni etj.

Gjatë punimit janë përdorur metoda sasiore të mbledhjes së të dhënave. Kjo më ka ndihmuar që më lehtë të bëjë krahasimin e variablave të ndryshme të përdorura për të testuar hipotezat e parashtruara. Metodë tjetër e përdorur në këtë punim është metoda përshkruese, përmes së cilës janë përshkruar zhvillimin e NVM-ve dhe krijimin e vendeve të punës në komunën e Obiliqit nga autorë të ndryshëm, të përmendur në pjesën e rishikimit të literaturës dhe njëkohësisht kam përshkruar edhe strategjitë që zbatohen nga qendrat e mëdha tregtare në Kosovë.

Për mbledhjen e të dhënave, kam realizuar takime me zyrtar komunal të komunës së Obiliqit për sa i përket NVM-ve në këtë komunë e cila më ka ndihmuar në realizimin e hulumtimit.

Në kuadër të metodologjisë së punës për hartimin e këtij punimi do të përdoren këto metoda:

- Metoda e analizës teorike (fillimisht është konsultuar literatura për kulturën e komunikimit në të cilën bëhet fjalë për këto probleme.
- Metoda empirike (të dhënat që do t'i fitojmë gjatë angazhimit tim nëpër NVM-të prodhuese në Kosovë)
- Metoda statistikore (rezultatet e marra janë të paraqitura në mënyra të ndryshme si: grafikone, tabela, etj.)
- Metoda deskriptive (i gjithë rezultati të përshkruhet se çfarë nxori ky hulumtim)

PËRFUNDIMET

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) që funksionojnë në Kosovë përballen me sfida të ndryshme në qasjen e tregut dhe informatave të nevojshme për të shtuar konkurrencën e tyre në vend. Mungesa e informatave mbi çmimet e tregut, standardet sanitare dhe të kualitetit, qasja në shërbimet e përballueshme financiare dhe të biznesit, janë disa nga sfidat kryesore me të cilat kryesisht përballen NVM-të në Kosovë.

H1 – Sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik kaluar në fazën e tranzicionit në një kahje drejt ekonomisë së tregut. Kjo hipotezë **është vërtetuar** pasi që nga hulumtimi kemi parë se NVM-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në tranzicionin e ekonomisë vendore.

H2 – NVM-të demonstrojnë një shkallë të lartë të novacioneve, fleksibilitetit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve të cilat ndodhin në rrethinë. Kjo hipotezë **është vërtetuar** pasi që nga hulumtimi kemi parë se NVM-të demonstrojnë novacione, fleksibilitet dhe adaptim ndaj ndryshimeve ekonomike që ndodhin në rrethinë.

H3 – Zhvillimi i NVM-ve manifestohet në rritjen e punësimit, rritjen reale ekonomike, reduktimin e varfërisë, nxitjen e kërkimeve shkencore, novatorizmin, etj. Kjo hipotezë **është vërtetuar** pasi që nga hulumtimi kemi parë se NVM-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm numrit të vendeve të punë. Kë e kemi parë nga hulumtimi në terren në NVM-të në Komunë e Obiliqit, të cilë kanë thënë se NVM-të e kanë rritur numrin e punëtorëve përgjatë viteve afarizëm të tyre.

